

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 115, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Delta Bay Resort”- Kompleks turistik, vila dhe hoteleri 2-3 kat në fshatin Palasë, Bashkia Himarë, kërkesë e shoqërive “Edonil Konstruksion” dhe “XH&M” sh.p.k.
2. Ngarkohen shoqëritë të kontribuojnë për restaurimin e Kishës së Shën Stefanit dhe Kishën e Ipapandisë , Dhërmi, Himarë, Vlorë, sipas projekt-preventivit të hartuar nga DRKK-ja Vlorë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI